



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË

INSPEKTORATIN E MBIKËQYRJES SË TREGUT

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	1-18
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	2-3
3. Konkluzioni i përgjithshëm	
a. Titulli.....	2-2
b. Marrësi.....	2-2
c. Objektivat III. 1, Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit4-	
II.Hyrje.....	5-5
a. Titulli.....	5-6
b. Marrësi.....	5-6
c. Objektivat dhe qëllimi.....	5-6
d. Identifikimi i çështjes.....	5-6
e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	5-6
ë. Përgjegjësitë e audituesve.....	5-6
f. Kriteret e vlerësimit.....	5-6
g. Standardet e Auditimit.....	5-6
h. Metodat e auditimit.....	5-6
i. Dokumentimi i auditimit.....	

II. Përshkrimi i i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit4-29

III.2. Përshkrimi i i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

-Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

-Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

-Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

-Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

-Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

-Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

- Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit.

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET.....29-29

III. DOKUMENTACION SHOQËRUES29-29



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë .06.2019 "Mbi auditimin tematik me objekt zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për periudhën 6 mujori të vitit 2021",

Programit të Auditimit nr. 795/1, datë 07.09.2022, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për përmirësimin e legjislacionit, marrjen e masave organizative, të masave disiplinore dhe të zhdëmtimit, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH për misionin e mëparshëm të realizuar në këtë objekt, ku rezultoi se:

Në përfundim të Auditimit me shkresën nr. me shkresën nr. 614/15 prot, datë 02.11.2021 ka dërguar në Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse, për periudhën 01.01.2019 deri më datën 30.06.2021.

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Me shkresë nr. 975/22 datë 18.11.2021 nga ana e ISHMT është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, Nga ana e ISHMT janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me shkresën nr 975/23 prot., datë 04.05.2022 me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 19 rekomandime gjithsej, nga këto: 19 masa organizative; si dhe janë rekomanduar masa disiplinore "vërejtje deri në largim nga puna" në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 559/8 prot, datë 25.03.2021 janë lënë **56 rekomandime** gjithsej, nga këto: **19 masa organizative, 9 masa shpërblim dëmi** në vlerën 7,434,000, **1 masa efekt financiar** në vlerën **700,000 lekë**, 27 masa disiplinore nga të cilët 1 nëpunës për masë për largim nga shërbimi civil për 4 nëpunës masë "vërejtje me paralajmërim" dhe për 22 nëpunës masa disiplinore "Vërejtje".

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së marrjes me qira të ambienteve për zyra, është konstatuar se: për pasurinë e llojit "Banim" me nr.6/67 + 1-2 (kati i dytë banim) ZK 8380, vol 38, faqe 160, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m², me mangësi në dokumentacionin vërtetues për garantimin e gëzimit të qetë të saj, në kushtet kur kjo pasuri ka qenë e bllokuar në favor të palëve të treta. Veprime që bien në kundërshtim me nenet 674, 802, 806, 807 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil në RSH", i ndryshuar, si dhe shkronjat "a" dhe "b" të pikës 35, si dhe pikën 36 në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

1.1. Rekomandim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (institucioni epror i ISHMT) të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjyqimit, për fillimin e procedurës së ndërprerjes së kontratës ndërmjet ISHMT dhe shtetasit A.N, si dhe sigurimin e ambienteve për zyra për ISHMT.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar

**I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit**

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellse: Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 559/8 prot, datë 25.03.2021 janë lënë **56 rekomandime** gjithsej, nga këto: **19 masa organizative**, **9 masa shpërblim dëmi** në vlerën 7,434,000, **1 masa efekt financiar** në vlerën **700,000 lekë**, 27 masa disiplinore nga të cilët 1 nëpunës për masë për largim nga shërbimi civil për 4 nëpunës masë "vërejtje me paralajmërim" dhe për 22 nëpunës masa disiplinore "Vërejtje".

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Për përmirësimin e gjendjes nga 19 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht **18 rekomandime**, është në proces zbatimi 1 rekomandim.*

*Për masa shpërblim dëmi janë lënë **9 rekomandime** në vlerën 7,434,000 lekë (pranuar pjesërisht 7 dhe papranuar 2, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 8, në proces zbatimi është vetëm 1), nga të cilat është rikuperuar dëmi nëpërmjet arkëtimeve dhe mos pagesave të qirasë vlera prej 5,677,214 lekë.*

*Për masa me efekt financiar është lënë **1 rekomandime** në vlerën 700,000 lekë (pranuar të gjitha, zbatuar plotësisht).*

*Janë lënë 27 **masa disiplinore** (1 masë "largim nga shërbimi civil", 4 masa "vërejtje me paralajmërim", 22 masa vërejtje)*

*Nga 56 rekomandimet Realizuar 54 rekomandime, 2 ne proces lënë 27 **masa disiplinore** Janë zbatuar ne masën 100%..*

I - HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 162/4 datë 14.02.2022 nga data 28.02.2022 deri në datën 18.03.2022, në Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, KLSH kreu auditimin e përputhshmërisë "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2021".

Auditimi përputhshmërisë u krye nga Grupi i Auditimit me përbërje:

A. M.	Përgjegjës grupi
L. K.	Auditues
V. B.	Audituese
R. K.	Audituese
R. A.	Auditues
Sh. H.	Audituese

Nga grupi i auditimit u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, një kopje e të cilit i dërgohet Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

1. Titulli - Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e ushtruar sipas programit nr. 795/8 datë 07.09.2022, të miratuar nga Kryetari i kontrollit të Lartë të Shtetit

2. Marrësi – Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut

3. Objektivat dhe qëllimi

Objektivat: Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të kryer në Drejtorinë e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

4. Identifikimi i çështjes

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut është person juridik, publik buxhetor, në varësi të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë dhe ka për objekt të veprimtarisë: Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", për hartimin dhe miratimin e metodikës për përcaktimin e vlerës së gjobës gjatë konstatimit të shkeljeve ligjore nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË

INSPEKTORATIN E MBIKËQYRJES SË TREGUT

subjektet, si dhe nuk është hartuar manuali i posaçëm për përllogaritjen e riskut, planifikimin e inspektimit dhe kryerjen e tij mbi bazë risku, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 1.3 kapitulli 1 në Urdhrin nr.13, datë 23.4.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH"; Neni 3 në Urdhërin nr.6, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut".

- Analizimi i riskut të veprimtarisë së ISHMT-së me qëllim përcaktimin e pikave të auditimit është bërë në kuadër të ligjit 10279 "Për kundërvajtjet administrative".

- Veprimtaria buxhetore dhe financiare e ISHMT -së i nënshtrohet legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Buxheti i Inspektoratit Shtetëror të Mbiqëqyrjes së Tregut me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

Nga analizimi i shpenzimeve, veçanërisht atyre që konsiderohen me risk si prokurimet publike, është konstatuar se për periudhën 01.01.2019 deri më datën 30.06.2021 janë kryer tenderë mbi vlerën 800 mijë leke.

5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Drejtimi ISHMT, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative",

Programet vjetore të inspektimit, sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat "a, c, ç dhe d" të pikës 2 të Urdhërit nr.5, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve";

- Si dhe me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi.

6. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi duhet të respektojë kërkesat etike, duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të siguri së kërkuar.

7. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i ndryshuar; Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së; Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), "Udhëzuesit e INTOSAI-t"; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikë më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik; Ligji nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative",

Programet vjetore të inspektimit, sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat "a, c, ç dhe d" të pikës 2 të Urdhërit nr.5, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve";

- Si dhe me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

8. Standardet e auditimit

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, Manuali për ndjekjen e zbatimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË

INSPEKTORATIN E MBIKËQYRJES SË TREGUT

rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

9. Metodat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.

Verifikimi i Urdhrave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

10. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit". Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur një akt-verifikim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit Inspektoratit Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1.1. Informacioni i përgjithshëm

ISHMT-ja ka për mision garantimin e sigurisë së produkteve joushqimore për konsumatorët, të vendosura në treg dhe në shërbim/në përdorim, nëpërmjet aktiviteteve mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi. ISHMT-ja është, gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe të të drejtave të tjera sipas fushës së veprimtarisë institucionale, objekt inspektimi. 2. ISHMT, është krijuar dhe funksionon nëpërmjet VKM nr.36, datë 20.01.2016 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut", i ndryshuar. Ky institucion është në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë. ISHMT është e organizuar si Drejtori e Përgjithshme dhe e shtrinë juridiksionin e vet në të gjithë territorin e vendit. Struktura e ISHMT është miratuar me Urdhrin nr.107, datë 31.07.2018, në fuqi deri më datë 31.07.2020 dhe është ndryshuar me Urdhrin nr.73, datë 01.06.2020 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë. Ky institucion.

II-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë .06.2019 "Mbi auditimin tematik me objekt zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme për periudhën 6 mujori të vitit 2021",

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Me shkresë nr. 975/22 datë 18.11.2021 nga ana e ISHMT është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021” NË

INSPEKTORATIN E MBIKËQYRJES SË TREGUT

rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, brenda 6 muajve nga marrja e shkresës, Nga ana e ISHMT janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me shkresën nr 975/23 prot., datë 04.05.2022 me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 559/8 prot, datë 25.03.2021 janë lënë **56 rekomandime** gjithsej, nga këto: **19 masa organizative**, **9 masa shpërblim dëmi** në vlerën 7,434,000, **1 masa efekt financiar** në vlerën **700,000 lekë**, 27 masa disiplinore nga të cilët 1 nëpunës për masë për largim nga shërbimi civil për 4 nëpunës masë “vërejtje me paralajmërim” dhe për 22 nëpunës masa disiplinore “Vërejtje”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Për përmirësimin e gjendjes nga 19 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht **18 rekomandime**, është në proces zbatimi 1 rekomandim.*

*Për masa shpërblim dëmi janë lënë **9 rekomandime** në vlerën 7,434,000 lekë (pranuar pjesërisht 7 dhe papranuar 2, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 8, në proces zbatimi është vetëm 1), nga të cilat është rikuperuar dëmi nëpërmjet arkëtimit dhe mos pagesave të qirasë vlere prej 5,677,214 lekë.*

*Për masa me efekt financiar është lënë **1 rekomandim** në vlerën 700,000 lekë (pranuar të gjitha, zbatuar plotësisht).*

*Janë lënë 27 **masa disiplinore** (1 masë “largim nga shërbimi civil”, 4 masa “vërejtje me paralajmërim”, 22 masa vërejtje)*

Nga të cilat 10 nëpunës janë të larguar dhe që nuk janë më në marrëdhënie pune pranë ISHMT-ës,

- 1 nëpunësit për të cilin është lënë rekomandim për “largim nga shërbimi civil”
- 3 nëpunës për të cilët është lënë rekomandimi “vërejtje me paralajmërim”
- 6 nëpunës për të cilët është lënë rekomandim “vërejtje”

Tabela Nr.1

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces/pjeserisht	Pa zbatuar	Nr. per	Në mijë/lek	Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
								Nr. per	Në mijë/lek	Nr. Pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1.	Masa organizative	19	18	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2.	Masa për përmirësim ligjor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.	Shpërblim dëmi	9	8	1	0	9	7,434,000	8	5,677,214	1	156,576	0	0
4.	Masa efekt financiar	1	1	0	0	1	700,000	1	200,000	0	0	0	0
5.	Masa disiplinore	27	27	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali	56	54	2	0	10	8,143,000	9	5,867,214	1	156,576*	0	0

Koment*: Në lidhje me rekomandimet me dëme ekonomike theksojmë që 8 rekomandime janë zbatuar ne vlerën 5,677,214 lekë, një rekomandim është në proces me vlerën 156,576 lekë. Për sa i përket diferencës 1,756,786 lekë me Vendim të APP me nr. 6793/5 prot., datë 10.06.2022



i është dhënë e drejtë autoriteteve kontraktore. Gjithashtu Masa me efekt financiar 1 gjobë është arkëtuar dhe për 3 gjoba janë dërguar nga ISHMT ku janë lëshuar Urdhërat ekzekutiv dhe janë përcjellë në përmbarim sipas rekomandimit.

Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

A1.Gjetje nga auditimi: Nga ISHMT nuk është respektuar përcaktimi ligjor në pikën 2, të nenit 10 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", për hartimin dhe miratimin e metodikës për përcaktimin e vlerës së gjobës gjatë konstatimit të shkeljeve ligjore nga subjektet, si dhe nuk është hartuar manuali i posaçëm për përlllogaritjen e riskut, planifikimin e inspektimit dhe kryerjen e tij mbi bazë risku, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 1.3 kapitulli 1 në Urdhrin nr. 13, datë 23.4.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në RSH"; Neni 3 në Urdhrin nr. 6, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut".

1.1 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat për hartimin dhe miratimin e rregullores, ku gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës për llojin e shkeljes, të merret në konsideratë historiku dhe frekuenca e shkeljeve të subjektit në vitin paraardhës, me qëllim shmangien e qëndrimit subjektiv të inspektorit në përcaktimin e masës së gjobës përballë shkeljeve të subjektit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Urdhëri Nr. 100, datë 22.04.2022 parashikon metodologjinë e përlllogaritjes së masës administrative vetëm në bazë të Ligjit për të Drejtën e Autorit dhe Ligjit për Pronësinë Industriale. Në datë 27.05.2022 nga ana e grupit të punës është dorëzuar me shkresën me nr. 1089 prot., grupi i punës ka dorëzuar metodologjinë e llogaritjes së masave administrative. Në datë 01.06.2022 me shkresën me nr. 1760 është dërguar për mendim pranë IQ-së metodologjia e llogaritjes së masave administrative. Gjithashtu është dërguar e-mail pranë IQ-së për sugjerime/komente i cili nuk mund të disponohet për shkak të mosfunksionimit të programit kompjuterik outlook, por bashkëlidhur gjendet rikujtesa me e-mail e datës 13.09.2022 dhe shkresa me nr.1760/2 datë 14.09.2022.

1.2 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat për hartimin dhe miratimin e manualit posaçme të inspektimit, referuar edhe përcaktimeve të bëra në manualin e përgjithshëm të inspektimit në RSH.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Bazuar në Urdhrin nr. 25 datë 10.08.2018 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektive si një proces i rregullt administrativ" është ripunuar Kapitulli VI i Rregullores së ISHMT-së : Procesi i Inspektimit. (sqaruar në Relacionin Shpjegues dërguar MFE nëpërmjet e-mail, nr.prot 1216/1 datë 0206.2022.)

Hapat e ndjekura:

- Urdhri nr. 22 datë 09.02.2022 " Për ngritjen e grupit të punës për ndryshimin e Rregullores së Brendshme të ISHMT-së"
- Draftimi i rregullores së re nga Grupi I Punës
- Shkresa nr. 1216 prot., datë 29.04.2022 me lëndë "Shkresë përcjellëse për miratimin e Rregullores së Brendshme të ISHMT-së", është përpiluar draft rregullorja e brendshme ku



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË

INSPEKTORATIN E MBIKËQYRJES SË TREGUT

është ndërhyrë në Kapitullin VI "Procedura e inspektimit" me plotësime dhe detajime sipas rekomandimeve të KLSH-së. Komunikimi nëpërmjet e-mail me MFE për plotësimin e disa sugjerimeve të propozuara nga MFE. - Përgatitja e relacionisht shpjegues në lidhje me ndryshimet e bëra në Rregulloren e ripunuar e cila iu dërgua MFE nëpërmjet e-mail nr.prot..1216/2. datë 02.06.2022

2.Gjetje nga auditimi: Programi vjetor i inspektimit, për periudhën 2019-Qershor 2021, nuk është hartuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat "a, c, ç dhe d" të pikës 2 të Urdhrit nr. 5, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve";

-Programet mujore të inspektimit për periudhën 2019-Qershor 2021, nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi".

2.1 Rekomandimi: ISHMT për subjektet e inspektuara në 3 vitet e fundit, të bëjë një vlerësim të sjelljes së tyre ndaj respektimit të kërkesave ligjore, si dhe në bazë të këtij vlerësimi, të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët), e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre, gjatë planifikimit të inspektimit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

1) Hartimi i Metodologjisë së Riskut. Metodologjia e riskut është përpiluar nga Drejtoria Teknike në bashkëpunim me të gjithë sektorët e DMP dhe DPI e cila i është dorëzuar Kryeinspektorit për miratim Nr.prot.2006 datë 10.06.2022. Metodologjia i është ngarkuar për zbatim DMP dhe DPIi me Urdhrin nr. 143 datë 15.06.2022 "Për zbatimin e Metodologjisë mbi vlerësimin e riskut që lidhet me veprimtarinë inspektuese të ISHMT-së"

2) Në bazë të Urdhrit nr. 80 datë 08.04.2022, është dorëzuar pranë DT baza e të dhënave të subjekteve që janë inspektuar në periudhën 2018-2022. Gjithashtu për përditësimin e kësaj baze të dhënash janë dërguar shkresa për informacion rreth subjekteve sipas fushë veprimtarisë së ISHMT-së në DPD, DPT, DPM, ISHTI. Shkresat drejtuar DPT nr. prot. 829-833 datë 07.04.2022; Shkresa nr.prot.967 datë 11.04.2022, shkresa nr. prot 991 datë 11.04.2022; Shkresa nr.prot.992 datë 12.04.2022; Shkresa Nr.prot.1006 datë 14.04.2022; Shkresa nr.prot.1080 datë 20.04.2022. baza e të dhënave do të shërbejë për realizimin e analizës së riskut nga çdo sektor.

2.2 Rekomandimi: Gjithashtu planet mujore t'i përcillen për mendim Inspektoratit Qendror dhe me pas të miratohen nga titullari i institucionit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Në raportin dërguar KLSH pas raportit paraprak të dërguar prej tyre janë bashkëngjitur të gjitha planet e punës të miratuara nga IQ për periudhën 2018-2021. Një kopje gjendet në protokoll.

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, është konstatuar se në **9 raste**, në kryerjen e procedurës së shkatërrimit të produkteve të ndaluara për tregtim, nuk administrohet dokumentacioni (*rekomandimi i Komisionit të Menaxhimit të Riskut, plani i shkatërrimit, procesverbali i asgjësimit/shkatërrimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedure, ISHMT, Inspektori mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i*



transferimit të mbetjeve, kontrata e shërbimit ndërmjet gjeneruesit të mbetjeve dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve në landfill, fletë-dalja e produkteve nga subjekti, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në mjetet e shkatërrimit dhe dërgimit të tyre në landfill, etj), në përputhje me kërkesat ligjore të bëra në VKM nr.742, datë 20.11.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteve"; Pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"; Kreun VIII të VKM nr.452, datë 11.7.2012 "Për lëndfilllet e mbetjeve", i ndryshuar, me qëllim identifikimin e kushteve të nevojshme për ruajtjen, trajtimin, transportimin dhe shkatërrimin e tyre dhe vërtetimin e këtij procesi.

3.1.Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, që çdo procedure asgjësimi/shkatërrimi, të dokumentohet plotësisht, ku pjese e dosjeve, të jenë edhe procesverbali i asgjësimit i mbajtur nga Inspektoret e mjedisit, Policia Vendore, dokumenti i transferimit të mbetjeve, flete-dalja e produkteve nga magazina e subjektit privat, kontrata e shërbimit të shkatërrimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitimin e tyre në landfill.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Në rregulloren e rishikuar e cila i është car për miratim MFE me shkresën nr.prot.1216 datë 29.04.2022 është përfshirë edhe ndalimi i tregtimit dhe shkatërrimi i produkteve që nuk plotësojnë kriteret ligjore sipas legjislacionit specifik në Nenin nr.79 dhe Nenin nr.80

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në të cilat sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalet dhe vendimet e inspektimit, është bërë bllokimi i produkteve të rrezikshme/jo konforme për përdorim nga konsumatori, është konstatuar se **në 14 raste** (për produktet si instrumente karburanti, lodra, etj), në këtë procedurë, nuk dokumentohet me foto vendosja shenjave dalluese të bllokimit/vendosja e masës "bllokim", si dhe administrimi i produkteve të bllokuara në magazina të dedikuara për këtë qëllim, mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën a të nenit 41, shkronjën ç të pikës 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe pikën 18 të Kreut III të VKM nr.742, datë 20.11.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të shkatërrimit të produkteve".

4.1 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektorët të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjites për bllokimin e produkteve, plumbçe, etj), me qëllim që në çdo praktike bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të dokumentohet me foto në çdo rast.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Me Urdhrin nr. 23 datë 10.02.2022 është ngritur grupi Punës për përpilimin e Udhëzimit mbi përcaktimin e rregullave dhe procedurave të ndalimit të tregtimit të produkteve jo në konformitet., i cili ka përgatitur Udhëzimi mbi përcaktimin e rregullave dhe procedurave të ndalimit të tregtimit të produkteve jo në konformitet me shkresën nr. 24/1 datë 20.06.2022.

4.2 Rekomandimi: Gjithashtu të analizohet dhe vlerësohet mundësia e investimit në blerjen/ndërtimin/marrjes me qira (alternativa ekonomikisht e favorshme) të një magazine/ambienti të posaçme, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit



dhe që do të asgjësohen/shkatërrohen, të ruhen në këto ambiente, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në këto ambiente, t'u tarifohet subjekteve në të cilat është herë bllokimi, deri në momentin e asgjësimit/shkatërimit. Në këtë mënyrë cdo produkt, i cili bllokohet, nuk do t'i lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit të futet përsëri në treg.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Është lidhur kontrata e Huapërdorjes nr. 1001/6 prot., datë 21.07.2022 me "Drejtorinë e Përgjithshme të Rezerva Materiale të Shtetit" me objekt " Dhënia me huapërdorje, pa kundër shpërblim, nga ana e huadhënësit tek huamarrësi, i sipërfaqes prej 381.15 m2, në depon me nr. 3 (me soletë harkore), pranë Agjencisë Shushicë me vendodhje në Elbasan nën përgjegjësi administrimi të DRRMSH Tiranë për depozitimin e produkteve të bllokuara që për shkak të mos përmbushjes së kriterëve ligjore do ti nënshtrohen procesit të shkatërimit".

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **18 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në **12 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga ISHMT nuk është autorizuar ri-inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre, veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 4 dhe 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", dhe pikën 16 të Kreut IV të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2018 për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ".

5.1 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, për autorizimin e inspektimeve me qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohen shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohen afate konkrete për korrigjimin e tyre duke këshilluar subjektet për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Rekomandimet e KLSH dhe rekomandimet e Raportit të Monitorimit të procesit të Inspektimit nga IQ, i janë bërë prezentë përgjegjëseve të sektorëve/inspektorëve nëpërmjet e-mail dhe i është kërkuar zbatimi i tyre gjatë procesit të inspektimit. Gjithashtu çdo të premte sektorët kanë organizuar mbledhje pune ku janë diskutuar problematikat e hasura gjate punës si dhe problematikat e evidentuara nga Përgjegjësit e sektorit në lidhje me procedurat e inspektimit. (raportet javore të çdo sektori).

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në të cilat është marrë mostër për analizë laboratorike/testim për parapaketime, lodra, nga vetë ISHMT/operator të kontraktuar prej saj, në **45 raste** janë konstatuar mangësi të ndryshme:

- Në **26 raste** nuk dokumentohet marrja e mostrës (*mos pasqyrimi në procesverbal, mungesë të vërtetimit të marrjes së mostrës, protokoll-matjeve*), si dhe nuk pasqyrohet metoda e përdorur për analizimin e tyre, kryesisht në produktet e parapaketuara dhe lodrat;

- Në **6 raste** sasia e mostrës së marrë për analizë laboratorike nuk është e plotë;

- Në **13 raste** marrja e mostrës është bërë në mungesë të kompetencës ligjore për marrjen dhe testimin e tyre. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 4 të nenit 38 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH"; Pikën 4 të nenit 30 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet jo ushqimore", ndryshuar; Kreun I dhe tabelën nr.1 dhe nr.1/a në VKM nr.1352, datë 3.10.2008 "Për miratimin e rregullores për parapaketimet", e ndryshuar; Kreun



XIX të Urdhrit nr.305, datë 30.5.2014 "Për procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut".

6.1 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të inspektimit me dokumentacionin e munguar, si dhe për kryerjen e matjeve/testimeve të saktësisë së instrumentit matës së karburantit, në cdo rast që e gjykon të nevojshme t'i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ose personit juridik privat të autorizuar prej DPM.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Në bazë të Urdhrit Nr. 105, datë 28.04.2022 "Për shqyrtimin e praktikave të inspektimit dhe verifikimin e mënyrës së vendimmarrjes nga inspektorët e ISHMT-së" janë ngritur 5 grupe pune për kontrollin e procedurave të inspektimit të kryer nga inspektorët e dy drejtorive për periudhën Janar-Qershor 2022. Çdo grup pune ka përgatitur relacionet mbi çështjet e kontrolluara: Relacioni mbi shqyrtimin e praktikave të inspektimit të Sektorit të Inspektimit Metrologji Nr.1132/5 datë 31.08.2022; Relacioni mbi shqyrtimin e praktikave të inspektimit për Sektorin e Produkteve mekanike dhe Sektorin e Produkteve Elektrike nr.prot. 1132/6 datë 31.08.2022; Relacioni mbi shqyrtimin e praktikave të inspektimit të Sektorit Kimik dhe Sigurisë së përgjithshme nr. 1132/7 datë 31.08.2022. Gjithashtu rekomandimet e këtyre relacioneve u janë bërë prezent inspektorëve nëpërmjet e-mail. (Dërguar e-mail zyrtar drejtorët e DPM dhe DPI në datat 31.08.2022, 06.09.2022)

6.2 Rekomandimi: Gjithashtu nga ISHMT të merren masat që cdo procedure e marrjes së mostrës, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjes fizike dhe asaj online, të jenë: Autorizimi i inspektimit, liste-verifikimi, procesverbali standard i inspektimit (ku te pasqyrohet marrja e mostrës), vërtetimi i marrjes së mostrës në rastin e lodrave, si dhe të eliminohet nga përdorimi dokumenti "protokoll-matje", përdorur për produktet e parapaketuara, si një dokument jo zyrtar.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe Zbatuar pjesërisht. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Është ngritur Grupi I Punës për monitorimin e procedurës së inspektimit të kryer nga inspektorët e ISHMT me Urdhrin nr. 105 Datë 28/04/2022 "Për shqyrtimin e praktikave të inspektimit dhe verifikimin e mënyrës së vendimmarrjes nga inspektorët e ISHMT-së

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit janë konstatuar mangësi të ndryshme lidhur me dokumentimin e veprimeve të kryera përgjatë inspektimit, plotësimin e dokumenteve standard të miratuara, të cilat cenojnë transparencën, efektivitetin/qëllimin e inspektimit si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Konkretisht mangësitë janë:

-54 raste listë-verifikimi i inspektimit (dokumenti standard në të cilin pasqyrohen shkeljet dhe respektimi i kuadrit ligjor nga subjekti) nuk është plotësuar në cdo rubrikë të tij, si dhe në 6 raste nga 54 gjithsej, ky dokument nuk administrohet në dosje ose nuk është plotësuar aspak;

-54 raste procesverbali i inspektimit nuk jep informacion të detajuar për veprimet e inspektorëve përgjatë inspektimit, ku theksojmë se në 32 raste nga 54 gjithsej, në dosjen e inspektimit administrohet një dokument "word" jozyrtar dhe i pamiratur, në të cilin pasqyrohen dhënat për produktet e inspektuara, të dhëna të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e inspektimit;

-60 raste nuk dokumentohen me foto produktet e inspektuara/nuk administrohet dokumentacion vërtetues i pohimeve të bëra prej inspektorëve, konkretisht të markimit CE të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË

INSPEKTORATIN E MBIKËQYRJES SË TREGUT

vendosur në produkt, deklaratave të konformitetit, paralajmërimet për detergjentët/ose produktet e rrezikshme, instruksionet e përdorimit për lodrat, etiketimin e produkteve;

-44 raste dokumentet justifikuese që administrohen në dosje, me qëllim vërtetimin e pohimeve të inspektorëve (pra kur detyrim ligjor kërkon që subjekti të ketë një dokument për të vërtetuar sigurinë e produktit), që subjekti plotëson detyrimin ligjor, janë fotokopje dhe pa nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit të inspektuar;

-16 raste në inspektimet jashtë planit (mbi bazë indicie/ankesë) autorizimi i inspektimit nuk përmban informacion të hollësishëm, pra shkaqet, burimin e informacionit për të cilin është iniciuar një inspektim jashtë programi, ankesën/indicien.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 1 të nenit 39, si dhe shkronjat "a" dhe "e" në nenin 41 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH"; Pikën 3.2 në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.4.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë", Kreun III dhe kolonën 7 në shtojcën 1 në Urdhrin nr. 25, datë 10.8.2018 "Për miratimin e rregullores "për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ".

7.1. Rekomandimi: Nga ISHMT të merren masat që, gjatë hartimit të procesverbalit të inspektimit sipas formatit të miratuar, të jepet informacion i detajuar për veprimet e inspektorëve përgjatë inspektimit dhe për çdo rast të inspektimeve, të plotësohet listë-verifikimi në të gjitha rubrikat e tij, si dhe rubrika "komente" me arsyetimin përkatës.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi janë nxjerrë memot dhe vijon si më poshtë:

"Referuar këtij rekomandimi ISHMT ka ngritur Urdhrin nr. 105, datë 28.04.2022, në bazë të së cilit janë kontrolluar praktikat e inspektimit për periudhën Janar-Qershor 2022 nga ku janë gjetur konstatime të cilat janë referuar Kryeinspektorit të ISHMT me memot:

Memo nr. 1132/8 prot., datë 07.09.2022 ""Për shqyrtimin e praktikave për Sektorin e Pronësisë Industriale dhe Sektorin e të Drejtës së Autorit"".

Memo nr. 1132/7 prot., datë 31.08.2022 ""Për shqyrtimin e praktikave për Sektorin Kimik dhe Siguria e Përgjithshme"".

Memo nr. 1132/5 prot., datë 31.08.2022 ""Për shqyrtimin e praktikave për Sektorin e Inspektimit Metrologjik"".

Memo nr. 1132/6 prot., datë 31.08.2022 ""Për shqyrtimin e praktikave për Sektorin e Produkteve Elektrike dhe për Sektorin e Produkteve Mekanike"".

Për gjetjet e konstatuara është vepruar nga eprorët direkt me tërheqje vëmendje, këshillim për unifikimi e praktikave dhe përmirësimin e mbajtjes së procedurave të inspektimit, sipas rastit."

7.2 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, që inspektimet jashtë planit të miratuar (të autorizuar mbi baze ankese, indicie), të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm, shkaqet, burimin e informacionit, ankesën/indicien etj.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Në rregulloren e rishikuar e cila i është çuar për miratim MFE me shkresën nr.prot.1216 datë 29.04.2022 është përfshirë në Nenin 76 zbatimi I procedurës kur kemi të bëjmë me inspektime të pa programuara mbi baze ankese apo nga arsye të tjera të shprehur në Ligjin nr. 10443/2011 "Për inspektimin në RSH".

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit u konstatua se:

- Në **32 raste** nuk është zbatuar plotësisht objekti i inspektimit përcaktuar në autorizimin e tij (moskryerja e inspektimit të instrumenteve matës, markimit CE të produkteve, etj), ku



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2021" NË

INSPEKTORATIN E MBIKËQYRJES SË TREGUT

theksojmë se në 11 raste (të subjekteve që tregtojnë detergjentë) nga 32 gjithsej, inspektimi nuk është kryer aspak, por është anuluar në mungesë të arsytimit ligjor dhe të aktit të titullarit të institucionit për anulimin e tij, duke mos realizuar në këtë mënyrë, qëllimin e inspektimit pranë këtyre subjekteve. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 50 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 "Për metrologjinë", i ndryshuar (shfuqizuar në Dhjetor të vitit 2020) dhe nenin 48 të Ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për metrologjinë"; Nenin 29 të Ligjit nr.10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore"; Shkronjën "a" të pikës 2 në nenin 4 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH"; Nenin 11 në Ligjin nr.10216, datë 21.01.2010 "Për detergjentet"; Pikën 4 në Kreun II të VKM nr.36, datë 20.01.2016 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT", ndryshuar;

- Në **11 raste** inspektimi është i pavlefshëm, nga të cilat në **5 raste** ai është kryer **jashtë afatit** të përcaktuar në autorizimin e inspektimit, **5 raste baza ligjore** e përdorur për verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga subjekti i inspektuar, **ka qenë e shfuqizuar**, si dhe në **1 rast** vendimi përfundimtar i inspektimit është marrë jashtë afatit 30-ditor nga data e mbajtjes së procesverbalit të inspektimit. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 4, pikën 4 të nenit 29 dhe pikën 3 të nenit 45 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH"; Pikën 2 të nenit 99 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Pikën 6 të VKM nr.349, datë 29.4.2020 "Për miratimin e rregullit teknik "për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara".

8.1 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme që, në çdo inspektim të garantohet zbatimi i plotë i objektit të inspektimit, si dhe kryerja e tij brenda afatit të përcaktuar në autorizimin e inspektimit, në rastet kur kjo është objektivisht e pamundur, anulimi i tij të bëhet me akt të titullarit të institucionit, i cili duhet të jetë i arsyetuar.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Në rregulloren e rishikuar e cila i është çuar për miratim MFE me shkresën nr.prot.1216 datë 29.04.2022 është përfshirë në Nenin 78 anulimi i çështjeve të inspektimit në sistemin e-inspektimi.

8.2 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat për ndryshimin e bazës ligjore (në dokumentet standarde të inspektimit) të përdorur në inspektimin e produkteve elektrike, bazë ligjore e cila është shfuqizuar me VKM nr.349, datë 29.4.2020 "Për miratimin e rregullit teknik "për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara".

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Është realizuar. Listë verifikimi është korrigjuar, miratur nga IQ (shkresa nr. 1848 datë 17.08.2021) dhe është gjeneruar në sistemin E-inspektimi.

8.3 Rekomandimi: Mbështetur në nenin 5, 8 dhe 9 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe në nenin 9 të Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 7, datë 19.02.20152, me qëllim rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së inspektimit, Titullari i ISHMT të ngrejë një grup pune (me punonjës që nuk janë të përfshirë në inspektim), i cili cdo 6-mujor, të kryejë vlerësim të praktikave të inspektimit



(duke përzgjedhur një kampion sa më gjithëpërfshirës të tyre), mbi zbatimin e kuadrit ligjor përkatës nga inspektorët.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Është ngritur Grupi I Punës për monitorimin e procedurës së inspektimit të kryer nga inspektorët e ISHMT me Urdhrin nr. 105 Datë 28/04/2022 "Për shqyrtimin e praktikave të inspektimit dhe verifikimin e mënyrës së vendimmarrjes nga inspektorët e ISHMT-së". Aktualisht janë kontrolluar praktikat e inspektimit të 6 sektorëve për periudhën Janar-qershor 2022. Gjithashtu për kontrollin e procedurës së inspektimit do ti referohemi edhe Raportit të Monitorimit nga IQ që behët çdo fund viti.

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të inspektimit u konstatua se:

- Në **60 raste** ndaj subjekteve që kanë qenë në shkelje të ligjit nuk është marrë masë administrative gjobë, si dhe në **22 raste** në 60 gjithsej veç masës administrative gjobë nuk është vendosur ndalimi i përdorimit të instrumentit matës të karburantit, matësve të ujit, tregtimit të produkteve të ndryshme elektrike, korrigjimit të shkeljeve, njoftimit të konsumatorit, etj;
- Në **7 raste** masa administrative e marrë me vendim të ndërmjetëm, është hequr në vendimin përfundimtar të inspektimit në mungesë të arsytimit ligjor. Kjo për produkte të ndryshme si Rezistenca, Bolier, Panel Diellor, Dekoder dixhital, Kamera inteligjente, Bateri për kompjuter PC, Ngrohës të ndryshëm, Hekur rrobash etj;
- Në **12 raste** trajtim me dy standarde në marrjen e vendimeve/kryerjen e veprimeve inspektuese në subjekt;
- Në **1 rast**, ku nuk është kryer kallëzim penal ndaj subjektit tregtues të karburanteve, i cili nuk ka lejuar kryerjen e inspektimit, si dhe ka dëmtuar vulat e bllokimit të instrumenteve, duke kaluar në regjim manual të përdorimit të tyre dhe ndërprerje të lidhjes së instrumentit me kasën fiskale. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 50 dhe nenin 64 të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 "Për metrologjinë", i ndryshuar; Nenin 43, 48 dhe 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH"; Nenin 27, 30 dhe 35 të Ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet jo ushqimore", ndryshuar; Nenin 182 dhe 235 të Ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar; Nenin 13 dhe pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

9.1 Rekomandimi: ISHMT për çdo subjekt shkelës të kuadrit ligjor përkatës, duke patur në konsideratë historikun e sjelljes së tij lidhur me respektimin e kërkesave ligjore brenda 3 viteve të fundit, rëndësinë e shkeljes, si dhe kur shkelja përbën kundërvajtje administrative, të marrë masë administrative "gjobë", urdhërimin e subjektit për korrigjimin e shkeljeve, si dhe sipas rastit, njoftimin prej tij të konsumatorit

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Është ngritur Grupi I Punës për monitorimin e procedurës së inspektimit të kryer nga inspektorët e ISHMT me Urdhrin nr. 105 Datë 28/04/2022 "Për shqyrtimin e praktikave të inspektimit dhe verifikimin e mënyrës së vendimmarrjes nga inspektorët e ISHMT-së". Gjithashtu për kontrollin e procedurës së inspektimit do ti referohemi edhe Raportit të Monitorimit nga IQ që behët në fund të vitit.

9.2 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, që të shmange trajtimin me dy standarde të subjekteve, të cilët gjenden në kushte të njëjta lidhur me respektimin/mosrespektimin e kuadrit ligjor përkatës.



Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Është ngritur Grupi I Punës për monitorimin e procedurës së inspektimit të kryer nga inspektorët e ISHMT me Urdhrin nr. 105 Datë 28/04/2022 "Për shqyrtimin e praktikave të inspektimit dhe verifikimin e mënyrës së vendimmarrjes nga inspektorët e ISHMT-së". Aktualisht janë kontrolluar praktikat e inspektimit të 6 sektorëve për periudhën Janar-qershor 2022. Gjithashtu për kontrollin e procedurës së inspektimit do ti referohemi edhe Raportit të Monitorimit nga IQ që behët cdo fund viti. Referuar gjetjeve të raporteve të monitorimit do të merren masa ndaj inspektorëve në së konstatohen shkelje të rënda të procedurës së inspektimit.

10.Gjetje nga auditimi: Në ISHMT, për të dy vitet 2019-2020, u konstatua se:

- Nuk janë mbajtur të dhëna analitike për të ardhurat dhe shpenzimet (ditarët e të ardhurave dhe shpenzimeve, ditari i veprimeve të ndryshme dhe libri i madh);
- Në ditarin e Bankës, regjistrimet kontabël prekin vetëm llogaritë financiare dhe të shpenzimeve dhe jo të gjithë llogaritë e tjera;
- Regjistri i aktiveve ka mangësi lidhur me plotësimin e kërkesave minimale siç janë: data e daljes në përdorim, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes. Këto mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, pikën 28 në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Udhëzimin e MFE nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, pikat 26-33 dhe pika 30.

10.1 Rekomandimi: ISHMT të hape dhe të mbajë librat analitike të të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, si dhe të gjithë ditarët e tjerë dhe analizat/libri i madh. Në ditarin e Bankës, regjistrimet kontabël të kryhen në llogaritë financiare dhe të llogarive të tjera, sipas veprimeve dhe ngjarjeve konkrete dhe të mos kalohen në cdo rast direkt në shpenzime. Për pasqyrat financiare, të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Të gjitha veprimet që janë kryer nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve (urdhër pagesat, detyrimet ndaj të tretëve, faturat e blerjes, fletë hyrjet, fletë daljet, si dhe veprimet me aktivitet afatgjatë dhe afatshkurtra materiale etj) kontabilizohen dhe mbahen në mënyrë informatike në programin Financa 5, ku pasqyrohen të gjitha veprimet që ju keni përmendur Në bazë të Pikës Nr. 1, Nenit Nr. 7 të Ligjit Nr. 25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" ku citohet : "Regjistrimet kontabël justifikohen me dokumentet kontabël, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre".

Është përgatitën në formatin excel, siç e ka kërkuar grupi i Auditimit të KLSH (pavarësisht se Programi Financa 5, është program specifikisht për pjesën e hedhjes së të dhënave financiare dhe kontabilizimin e tyre) ditarët e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2019 – 2021. Është përpiluar Regjistri i Aktiveve të Institucionit sipas rekomandimeve të grupit të Auditimit.

11.Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2020, lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit, në pasqyrat financiare nuk evidentohet shuma e akumuluar e amortizimit në llogaritë 209 dhe 219, nuk evidentohet llogaria 1013 por vetëm në pasqyrën nr.4, si dhe në pasqyrën e Performancës financiare Rubrika 7, Llogaria 681 "Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit". Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumatat e amortizimit të akumuluar



209 dhe 219, respektivisht për Aktivet afatgjata jo materiale dhe Aktivet afatgjata materiale, si dhe paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 31.

11.1 Rekomandimi: ISHMT të marrë masa për të ardhmen lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit dhe në pasqyrat financiare të evidentojë shumat e akumuluar të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, dhe të evidentohet llogaria 1013. Llogaria 681, te evidentojë saktësisht shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Në lidhje me mosparaqitjen në Bilancin e vitit 2020 të amortizimit të akumuluar për aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale, (formati F7 AAGJ), ju bëjmë me dije se në tabelën e dytë të këtij formati me emërtimin : "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera Neto)", është paraqitur kosto historike, amortizimi i akumuluar si dhe teprica neto për aktivet materiale të ISHMT-së (bashkëlidhur tabela e sipërcituar). Pra është zbatuar me përpikëri dhe rigorozitet pika 31 e Udhëzimit Nr. 8, datë 09.03.2018 "Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" ku citohet shprehimisht : "Aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre" si dhe pika 33 e po këtij Udhëzimi: "Aktivet afatgjata materiale paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike, minus amortizimin e akumuluar".

Është marrë në konsideratë fakti dhe në bilancin dhe pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe viteve në vazhdim në formatin F2 – Performanca Financiare, janë/do të, pasqyrohen në llogarinë 681 shuma vjetore e amortizimit të AAGJ.

C.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në Ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të kërkohet në rrugë administrative dhe ligjore, shpërblimin e dëmit të krijuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 7,434 mijë lekë¹, si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së marrjes me qira të ambienteve për zyra, është konstatuar se:

-Janë paguar 1,545,771 lekë për pasurinë e llojit "Banim" me nr.6/67 + 1-2 (kati i dytë banim) ZK 8380, vol 38, faqe 160, datë 27.08.2020, sipërfaqe 191.6 m², me mangësi në dokumentacionin vërtetues për garantimin e gëzimit të qetë të saj, në kushtet kur kjo pasuri ka qenë e bllokuar në favor të palëve të treta. Veprime që bien në kundërshtim me nenet 674, 802, 806, 807 të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil në RSH", i ndryshuar, si dhe shkronjat "a" dhe "b" të pikës 35, si dhe pikën 36 në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-Janë paguar 4,303,094 lekë paradhënie për 6 muaj, për rregullime/punime në objekt, në mungesë të miratimit paraprak të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, në mungesë të referimit ligjor specifik siç kërkohet. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikat 160 dhe 161 të Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.



1.1.Rekomandime: ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për fillimin e procedurës për arkëtimin nga pronari i objektit, shtetasi A. N, të dëmit ekonomik në vlerën 1,545,771 lekë, shkaktuar në buxhetin e shtetit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Akt konstatimi mbi vlerën e pagesës së dëmit ekonomik për kontratën e qirasë Nr. 1921/9 datë 14.09.2020. me Nr. 975 Prot datë 16.11.2021

Njoftim për kthimin e dëmit në zbatim të kontratës së qirasë nr.1921/9 datë 14.09.2020. me Nr. 2831 Prot Datë 15/11/2021

Detyrimi i rillogaritur 1 374 120 lekë likuiduar në buxhet si e ardhur për ISHMT me datë 23.03.2022. Bashkëlidhur mandat arkëtimi.

1.2. Rekomandim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (institucioni epror i ISHMT) të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për fillimin e procedurës së ndërprerjes së kontratës ndërmjet ISHMT dhe shtetasit A. N, kthimin në buxhetin e shtetit të shumës së paradhënies përfituar nga pronari i objektit, në vlerën 4,303,094 lekë, si dhe sigurimin e ambienteve për zyra për ISHMT.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Me shkresën Nr. 2815 Prot datë 12.11.2021 është kërkuar degës së thesarit Tiranë për konfirmimin për mospagesë të qirasë mujore

Bashkëlidhur gjendet kthim përgjigje nga thesari me Nr. 7008/1 Prot, datë 12.11.2021. "Për mospagim të qirasë nga Qershori - Nëntor 2021".

Për sa i përket këtij rekomandimi për prishje kontrate nuk është në tagër të ISHMT , por i referohet organit epror Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik për vitin 2019 "blerje instrumente dhe pajisje për inspektim në terren", është konstatuar se, OE "F" shpk, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike në DST (vlerësimi i konformitetit dhe vendosja e markimit CE në produkt, element kostoje të produktit por që nuk mund të maten), mallin e kërkuar "Sky Ray Instrument-Spektometër" në vlerën 2,250,000 lekë pa TVSH

2.1 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE "F" shpk, të dorëzojë aparatën "Spektrometer" në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerës 2,250,000 lekë pa TVSH.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi është nxjerrë urdhri dhe vijon si më poshtë:

Shkresë Dërguar F. më datë 2863/2 datë 15.12.2021 " Mbi gjetjet e KLSH për procedurën Blerje pajisje Laboratorike për ISHMT". Përgjigje kthyer nga OE F me Nr. 2863/3 Datë 16.02.2022, sipas të cilës paraqet se Instrumenti "Sky Ray Explorer 3000 Instrument-Spektrometër" është në përputhje me specifikimet teknike dhe ka paraqitur Deklaratën e Konformitetit nëpërmjet së cilës verifikon përputhshmërinë me Directiven EMC (2014/30/EU) dhe LVD 2006/95/EC. Gjithashtu sa i përket markimit shpjegon se për shkak të natyrës së produktit Markimi CE nuk është i detyrueshëm të vendoset në trup por mund të vendoset në paketim apo dokumentet shoqërues. Më tej i është përcjellë Shkresë Nr. 2863/4 07.03/2022 OE F, me objekt përkthimin e dokumentacionit të paraqitur me Shkresë Nr.2863/3 datë 16.02.2022; Kthim përgjigje F me Nr.863/5 datë 16/03/2022 nëpërmjet të cilit paraqet



dokumentacionin Deklaratë Konformiteti të përkthyer dhe të noterizuar. Nuk është marrë në shqyrtim nga APP.

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik për vitin 2020 "blerje instrumente dhe pajisje për inspektim në terren", është konstatuar se, OE "N" shpk, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike në DST (vlerësimi i konformitetit, vendosja e markimit CE në produkt, kalibrimi i instrumenteve, element kostoje të produktit por që nuk mund të maten), mallrat e kërkuara në vlerën 2,454,000 lekë.

3.1 Rekomandimi: ISHMT të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, duke i kërkuar OE N. shpk, të dorëzojë mallrat "Matës i shkallës së ndriçimit, Seri gramarësh lg-500g, Seri gramarësh lmg-500mg, Aparat për matjen e volumit të gazit, Kronometer, si dhe Testues izolacioni multimeter" në përputhje me specifikimet teknike të kontraktuara, ose në të kundërt arkëtimin e vlerës 2,454,000 lekë pa TVSH, të produkteve të mësipërme.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Shkresa e nisur mbi gjetjet e KLSH me Nr 2861 Prot, e datës 15.11.2021, drejtuar OE "N", Sh.p.k Përgjigja ardhur nga N me Nr. 2861/1 datë 10.02.2022 nëpërmjet së cilës:

1)Për Pajisjen matës i shkallës së ndriçimit ka paraqitur dokumentacionin teknik që demonstroi përputhjen me specifikimet teknike sipas DST.

2) Për setin e gramarëve shpjegon se OE N ka dorëzuar për zërin 14 dhe 15 të FO, seri gramarësh nga prodhuesi H, të shoqëruar me certifikatën e kalibrimit, MAF të lëshuar nga prodhuesi si autorizim për N. SHPK, dhe deklaratat e konformitetit të respektimit të standardeve nga Prodhuesi (përkthyer noterizuar). Gjithashtu ka paraqitur rregulloren OIML që sqaron se Markimi CE nuk është i detyruar që të bëhet në trup nëse produkti shoqërohet me certifikatën e kalibrimit.

3)Për Pajisjen aparat i matjes së volumit të gazit, paraqet autorizimin nga prodhuesi SK G. E i cili deklaron se aparati i matjes së volumit është në përputhje të plotë me Direktivën 2014/32/EC (si referuar në shkresë Nr.2861/1 datë10.02.2022);

4) Për Pajisjen kronometër shpjegon se Prodhuesi EXTEXH-FLIR garanton përputhshmërinë me Direktivën EMC;

5) Në lidhje me testuesin e izolacionit multimeter, sqaron se instrumenti dhe Pajisja për testuesin e izolacionit i prodhuesit FLUKE është instrument për testimin e izolacionit 10 KË (bashkëlidhur shkresës specifikimet teknike të përkthyer që demonstroi përputhjen me kërkesat e DST)

Nga shqyrtimi i përgjigjes së APP rezulton se:

1) Në lidhje me konstatimet KLSH për furnizimet e mëparshme (KLSH I është referuar vetëm periudhës, jo vlerës jo më pak se 40 %), mbështet kundërshtimin e ISHMT, që nuk është e nevojshme të provojë eksperiencë në të tre vitet 2017-2020, por brenda 3 viteve. Në rast se përmbushet dhe kriteri i vlerës, kriteri konsiderohet i përmbushur. Nuk ka nevojë për dëshmi edhe për vitin 2017 detyrimisht (faqe 12-13);

2. lidhur me Garancinë e kontratës që pretendohet se është fotokopje nga KLSH, APP nuk mund të jap një vlerësim konkret 3. Lidhur me certifikatat e kalibrimit të lëshuara nga S. R. ne Ssystems d.o.o Evidetohet nënshkrim dhe certifikatat mund të gjurmohen me nr serial 4. Lidhur me pretendimin e KLSH se OE nuk ka provuar lidhjen me prodhuesin, ndërkohë nga verifikimi në sistemin elektronik APP thekson se janë paraqitur autorizimet përkatëse që plotësojnë kriterin përcaktuar për mallrat objekt prokurimi (faqe 15-17). Lidhur me certifikatat e kalibrimit për artikujt 4,Kalibër digital, 12 " Instrument Matës temperature me një sensor" NTC me bateri; 14 Seri gramarësh lg-500g, 15. Seri gramarësh lmg-500 mg, 16. Aparat për matjen e volumit të gazit", 17 " Kronometër" është kërkuar të jenë të pajisur me certifikatë



kalibrimi por nuk është specifikuar momenti i paraqitjes së tyre, në kundërshtim me pretendimin e KLSH që duhej të ishin paraqitur gjatë fazës së konkurrimit.

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët, për vitin 2020 "Pajisje për video konferencë dhe panel akses kontrolli", si dhe referuar fletë-hyrjes nr.19, datë 16.12.2020 të hyrjes së mallrave në magazinë e ISHMT, është konstatuar se, nga OE "A.O", person fizik, janë shtuar mallra/shërbime në vlerën 426,000 lekë, të cilat nuk kanë qenë objekt prokurimi sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 230, datë 07.12.2020, të Titullarit të ISHMT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (128-219) të Raportit të Auditimit)*

4.1 Rekomandimi: ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 426,000 lekë, nga OE "A. O" person fizik.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Referuar rekomandimeve të dhëna për OE "A. O", sipas vendimit nr. 55 datë 10.06.2022 të APP-s (faqe 21), janë pranuar kundërshtimet e Autoritetit Kontraktor në lidhje me gjetjet e kostatuara.

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët për vitin 2020 "blerje pajisje kompjuterike", është konstatuar se, OE "I Al" shpk, i shpallur fitues, nuk ka sjellë sipas specifikimeve teknike, mallrat e kërkuara (kompjuterë dhe laptop 20 copë gjithsej) në vlerën 712,450 lekë pa TVSH.

5.1 Rekomandimi: ISHMT të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e dëmit ekonomik shkaktuar në buxhetin e shtetit në vlerën 712,450 lekë, nga OE "I Al" shpk, si pasojë e mosdorëzimit nga ky i fundit të mallrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara, ose në të kundërt të kërkojë dorëzimin e tyre sipas specifikimeve teknike.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar. Në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon si më poshtë:

Referuar rekomandimeve të dhëna për OE "I Al", sipas vendimit nr.55 datë 10.06.2022 të APP-s, janë pranuar kundërshtimet e Autoritetit Kontraktor në lidhje me gjetjet e konstatuara. Për vitin 2022 anëtarët e komisionit të prokurimit me vlere të vogël kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit sipas përcaktimit të bere në Udhëzimin nr 3 date 8.01.2016 të APP dhe Udhëzimit Nr 3 date 24.10.2016 për gjobe procedure prokurimi të zhvilluar.

Me anë të shkresës nr. 6792/1prot., datë 16.11.2021 protkolluar me tonën me nr. 2916prot., datë 18.11.2021 nga Agjencia e Prokurimit Publik është kërkuar dërgimi i kundërshtimeve nga personat përgjegjës, shoqëruar me dokumentacionin provues, në lidhje me procedurat e prokurimeve për të cilat janë konstatuar mangësi në raportin e KLSH-së me nr. 614/16prot., datë 02.11.2021.

Nga ISHMT, bazuar në shkresën nr. 2916/1prot., datë 23.11.2021 është dërguar kthim përgjigjja si dhe dokumentacioni provues në lidhje me procedurat "Blerje pajisje kompjuterike-viti 2021 (faqja 113-163) dhe Blerje Pajisje kompjuterike -2020 (faqe 68-77) ku është përfshirë argumentimi përkatës si dhe i gjithë dokumentacioni i njësuar me origjinalin me vulën e institucionit.

Në vendimin nr. 55 prot., datë 10.06.2022 nga Agjencia e Prokurimit Publik, për procedurat e blerjeve për pajisje kompjuterike nuk është shprehur për aspektet procedurale të këtij prokurimi. Në Vendimin e sipërcituar është sjellë në vëmendje vetëm fakti që anëtarët e



komisionit të deklarojnë mbi kushtet e konfliktit të interesit, përveç momentit kur emetohen në këtë cilësi, edhe në kohën e hapjes së ofertave, ku deklarojnë lidhur me ofertuesit pjesëmarrës.

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik me vlerë të ulët për vitin 2021 "blerje pajisje kompjuterike", u konstatua se:

